

## E DREJTA PËR INFORMIM

### Studentë të Universitetit “Luigj Gurakuqi” takim në Zyrën e Komisionerit

Në mjediset e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zhvillua takimi me një grup studentësh të programit Gazetari-Komunikim të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.



Në këtë aktivitet, të zhvilluar në formën e një bashkëbisedimi të lirë, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, prezantoi një panoramë të legjislacionit të të drejtës për informim, i njohu me rolin, funksionet dhe veprimtarinë e institucionit në këtë fushë, si dhe mbi trajtimin e rasteve nga praktika. Një aspekt i rëndësishëm në këtë drejtin është forcimi i transparencës së autoriteteve publike, duke ndikuar në nxitjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së tyre përballë qytetarëve. Njëkohësisht, studentët shfaqën interes edhe për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, si një e drejtë tjetër themelore individuale, mbi raportet e saj me teknologjinë dhe digjitalizimin e shërbimeve. Zyra e Komisionerit informoi të pranishmit mbi veprimtarinë institucionale në këtë drejtim, si dhe ofroi këshilla praktike për një orientim të drejtë në funksion të mbrojtjes efektive të të dhënave personale.

Aktiviteti u zhvillua si pjesë e takimeve në institucione shqiptare në kuadër të projektit “Media 2040: avokimi i të rinjve për lirinë e medias në Ballkanin Perëndimor”, i cili realizohet nga gjashtë universitete të rajonit: Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Universiteti i Novi Sadit, Universiteti i Malit të Zi, Universiteti i Sarajevës dhe Universiteti i Shkupit “Shën Kirili dhe Metodi”. Zyra e Komisionerit e mirëpret bashkëpunimin me institucione të arsimit të lartë në kuadër të veprimtarive mësimore akademike/didaktike, si një mundësi për zgjerimin e ndërgjegjësimit dhe njohurive të të rinjve.



# Bashkëpunim për standarde të larta në respektimin e të drejtave të qytetarëve

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) e Kosovës shkëmbejnë eksperiencat më të mira për standarde të larta në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve.




Një grup nëpunësish të autoritetit homolog zhvilloi një vizitë studimore në Tiranë në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes dy institucioneve të nënshkruar në vitin 2022. Ky aktivitet ishte i ndarë në dy pjesë dhe preku një sërë çështjesh dhe tematikash që kanë të bëjnë me të dy fushat e përgjegjësive së autoriteteve, si edhe me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të tyre. Gjatë takimit u diskutuan gjerësisht raste praktike si të fushës së të drejtës për informim ashtu edhe të asaj për mbrojtjen e të dhënave personale apo për zhvillimin e inspektimeve të përbashkëta në sektorë të caktuar.



Njëkohësisht, u ndanë përvojat respektive në hartimin e akteve nënligjore apo udhëzuesve/opinionëve, si dhe u shkëmbyen ide për forcimin e kapaciteteve administrative dhe profesionale të AIP. Një pikë tjetër me rëndësi ishte dhe mbështetja e Zyrës së Komisionerit për avancimin e statusit/anëtarësimit të autoritetit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

KONSULTONI FAQEN [WWW.IDP.AL](http://WWW.IDP.AL) PER TU NJOHUR ME TË REJAT MË TË FUNDIT TË ZYRËS SË KOMISIONERIT

[WWW.PYETSHTETIN.AL](http://WWW.PYETSHTETIN.AL)



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE**

## Intervistë e Komisionerit Dervishi në Zërin e Amerikës (VoA) të Informimit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, ishte i ftuar në një intervistë në seksionin në gjuhën shqipe të Zërit të Amerikës (Voice of America – VoA).



I pyetur mbi situatën e zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit në vendin tonë, Komisioneri, ndër të tjera theksoi, se: “si në çdo fushë të veprimtarisë, si për çdo të drejtë dhe liri themelore të njeriut, situata është komplekse, pasi ndikojnë shumë faktorë. Është e vërtetë që ligji për të drejtën e informimit dhe këtë besoj se e pranojnë të gjithë, është një ligj i mirë, ai është përmirësuar akoma edhe më shumë me ndryshimet që ju bënë vitin e kaluar. Besoj se është bërë një proces model i konsultimit publik, me të gjithë grupet e interesit, me median investigative, me shoqërinë civile, për të patur një ligj sa më të mirë. Të gjitha sugjerimet e bëra u reflektuan, ndërsa disa problematika për të cilat media apo shoqëria civile nuk ishin dakord, natyrisht, që nuk u reflektuan në ndryshimet që u miratuan. Dhe kjo është e rëndësishme, ligji vijon të jetë një nga më të mirët në botë. Përsa i përket zbatimit të tij, ligji parashikon një instrument që është shumë i rëndësishëm, institutin e Programit të Transparencës, që përbën transparencën proaktive të institucioneve, që nënkupton informacionin që vetë autoritetet publike duhet të bëjnë publike pa kërkesë të qytetarit apo të interesuarve. Transparenca në vetvete është kulturë, të cilën edhe për shkak të historisë sonë nuk e kemi të trashëguar, është një kulturë e re që po e kultivojmë. Me ligjin për të drejtën e informimit ne jemi shumë pranë ndryshimit revolucionar të mentalitetit të autoriteteve publike”.

Ndërsa, i pyetur mbi zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Komisioneri tha, se: “sa më shumë zhvillime teknologjike të ketë, aq më shumë rriten rreziqet. Ajo që është kryesore dhe thelbësore është marrja e masave të përshtatshme të sigurisë. Vendi duhet të ketë një legjislacion të fortë dhe ne jemi duke ecur mirë në këtë drejtim. Kemi miratuar Konventën përkatëse të Këshillit të Evropës dhe jemi në proces të transpozimit të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) të Bashkimit Evropian. Por nga ana tjetër, kërkohen investime në burime njerëzore, kërkohen burime financiare, kërkohen trajnime të vazhdueshme, për të marrë masat e duhura të sigurisë. Sa më shumë shërbime online të ofrohen, që është diçka e mirë për qytetarët, aq më shumë kërkohet marrja e masave të sigurisë për të mbrojtur të dhënat personale, për të mbrojtur identitetin e çdo qytetari”.

## Zyra e Komisionerit në Konferencën “Mos u gënje nga informacioni i rremë”

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ishte e ftuar në Konferencën “Mos u gënje nga informacioni i rremë”, organizuar nga “Faktoje.al”.



Përfaqësuesja e Zyrës së Komisionerit, vlerësoi përpjekjet dhe veprimtarinë e kësaj organizate mediatike në kontrollin e fakteve, në mënyrë që informacioni të jetë i saktë dhe i besueshëm për publikun. Po ashtu, u theksua edhe bashkëpunimi ndër vite me Zyrën e Komisionerit për arritjen e qëllimit të përbashkët, kultivimin e kulturës së transparencës dhe rritjen e llogrithënies së autoriteteve publike.

Në këtë aktivitet, që përkoi edhe me Ditën Ndërkombëtare të Kontrollit të Fakteve (International Fact-Checking Day), u soll në vëmendje rëndësia e informacionit të verifikuar në ditët e sotme.

### Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



Komisioneri KDIMDP



IDP Albania



idp.albania



IDP Albania